



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR PASQYRAT FINANCIARE TË
KOMUNËS SË GLOGOCIT PËR VITIN 2019**

Prishtinë, korrik 2020

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë llogaridhënien e institucioneve publike, duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur për opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të *Komunës së Glllogocit*, në konsultim me Ndhmës Auditorin e Përgjithshëm *Naser Arllati*, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga *Ylber Sadiku* udhëheqës ekipi, *Fisnik Rudaj* anëtar dhe *Muharrem Qyqalla* anëtar, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit *Bujar Bajraktari*.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	5
1. Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore	6
2. Menaxhimi financiar dhe kontrolli	8
3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	26
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja	31
Shtojca II: Letër e konfirmimit	33

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti i përmbledhë çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Komunës së Glllogocit për vitin 2019, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm për Pasqyrat Financiare Vjetore. Ekzaminimi i Pasqyrave Financiare për vitin 2019 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA).

Auditimi është fokusuar në:



Konkluzionet

Konkluzioni për Pasqyrat Financiare Vjetore - Pasqyrat Financiare Vjetore ishin në përputhje me rregullat dhe me Standardet e zbatueshme, me përjashtim të keq-klasifikimit të shpenzimeve në mes të kategorive të ndryshme ekonomike. Kjo është shpjeguar në detaje tek Paragrafi për Theksimin e çështjes.

Konkluzioni për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin - Edhe pse kontrollet e brendshme kanë operuar në mënyrë efektive në disa fusha, menaxhimi financiar dhe kontrolli është përcjellë me dobësi evidente në disa sisteme të rëndësishme financiare. Kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtijshëm për të parandaluar: keqklasifikimin e shpenzimeve, anashkalimin e rregullave të prokurimit si dhe menaxhimin e projekteve kapitale.

Konkluzioni për zbatimin e rekomandimeve nga viti paraprak - Zbatimi i rekomandimeve të vitit paraprak nuk monitorohet në nivelin e duhur dhe nuk ka progres në zbatimin e tyre. Përkundër veprimeve të ndërmarra, ka nevojë për veprime shtesë për zbatimin e rekomandimeve tona.

Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm¹

Opinion i pa modifikuar me theksim të çështjes

Më gjerësisht shih kapitullin 1 të këtij raporti.

Përgjigja e menaxhmentit në auditimin 2019

Kryetari është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna. Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të Komunës gjatë procesit të auditimit.

¹ Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave të tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Auditimi është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Kemi analizuar veprimtarinë e Komunës së Glllogocit, nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale, si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që i kemi konsideruar të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Gjetjet e auditimit nuk duhen të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e dobësive që mund të ekzistojnë apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që janë aplikuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përshkrim të detajuar të gjetjeve dhe rekomandimeve në çdo fushë të audituar. Përgjigjet e menaxhmentit në rezultatet e auditimit mund të gjenden në Shtojcën II.

1. Opinioni i auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore

Ne kemi kryer auditimin e PFV-ve së Komunës së Glllogocit për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019, në përputhje me Ligjin e ZKA-së dhe Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Ekzaminimet e auditimit janë kryer për të mundësuar dhënien e opinionit për PFV, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme dhe pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, të shpalosura në detaje.

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2019, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik të kontabilitetit në para të gatshme.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Në përputhje me SNISA-t 10 dhe 30, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e PFV-ve të organizatave buxhetore, ZKA-ja është e pavarur nga Komuna. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin

Theksimi i çështjes

Ne dëshirojmë të tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Përkatësisht, për paga dhe mëditje janë paguar mjete nga mallrat/shërbimet, subvencionet dhe nga investimet kapitale, si dhe për mallra e shërbime janë paguar mjete nga investimet kapitale. Këto pagesa janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore, dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve si dhe për borxhe ndaj furnitorëve. Komuna ka bërë përpjekje për të evituar këto pagesa por ka qenë e pamundur, për shkak se nuk ka pasur mjete të aprovuara me buxhet për pagesën e tyre nga kategoritë adekuate.

Po ashtu, përmes planifikimit buxhetor, komuna ka kryer pagesa nga mallrat dhe shërbimet për subvencione dhe transfere si dhe investime kapitale, si dhe nga investimet kapitale ka kryer pagesa për mallra/shërbime dhe subvencione e transfere. Në këtë raport keqklasifikimet janë trajtuar tek kapitulli 2.1 Planifikimi dhe Realizimi i Buxhetit. Opinioni ynë nuk është modifikuar në lidhje me këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV-të

Kryetari i Komunës së Glllogocit është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të Pasqyrave Financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme. Po ashtu, menaxhmenti është përgjegjës edhe për vendosjen e kontrolleve të brendshme, të cilat i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e Pasqyrave Financiare, pa keq deklarime materiale të shkaktuara, qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë përmbushjen e kërkesave që burojnë nga Ligji nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullorja nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiar nga Organizatat Buxhetore.

Kryetari i Komunës është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Komunës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV-të në bazë të auditimit të kryer, në përputhje me SNISA-t. Këto standarde kërkojnë që të marrim siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keqdeklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keqdeklarim material që mund të ekzistojë. Keqdeklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keqdeklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnojë procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

Ne komunikojmë me menaxhmentin e entitetit të audituar në lidhje me fushëveprimin, kohën e planifikuar të auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne e identifikojmë gjatë auditimit.

Raporti i auditimit publikohet në web faqen e ZKA-së, me përjashtim të informacioneve që klasifikohen si të ndjeshme apo për shkak të ndalesave të tjera ligjore e administrative, në pajtim me legjislacionin në fuqi.

2. Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK) pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore dhe pasuritë e detyrimet si dhe funksionin e auditimit të brendshëm.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi të hyrat janë në përgjithësi të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar në mënyrë efektive. Megjithatë, kontrollet mbi shpenzimet kërkojnë përmirësim të mëtjeshëm për të parandaluar: keqklasifikimin e shpenzimeve, anashkalimin e rregullave të prokurimit, mangësitë në menaxhimin e projekteve kapitale si dhe menaxhimin e pasurive jo financiare.

2.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Burimet e Fondeve:	15,171,602	16,140,118	14,634,494	91	13,901,613	12,483,647
Granti i Qeverisë - Buxheti	13,701,841	13,701,841	13,065,870	95	12,498,679	11,237,166
Huamarrja	156,226	40,761	37,905	93	26,636	-
Të bartura nga viti paraprak ³ -	-	811,638	569,330	70	996,865	814,618
Të hyrat vetjake ⁴	1,313,535	1,313,535	732,610	56	373,453	425,819
Donacionet e brendshme	-	24,904	22,691	91	5,980	6,044
Donacionet e jashtme	-	247,439	206,090	83	-	-

² Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

³ Të hyrat vetjake të komunave të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual

⁴ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetanake

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte rritur për 968,516€. Kjo rritje ishte rezultat i të hyrave të bartura nga viti paraprak për 811,638€, donacioneve të brendshme për 24,904€ si dhe rritjes së donacioneve të jashtme për 247,439€. Përderisa, financimi nga huamarrja ishte zvogëluar për 115,465€.

Në vitin 2019, Komuna ka shpenzuar 91% të buxhetit final ose 14,634,494€, me një përmirësim prej rreth 5% krahasuar me vitin 2018. Më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale të realizimit të buxhetit.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Realizimi	% e Realizimit 2019	2018 Realizimi	2017 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	15,171,602	16,140,118	14,634,494	91	13,901,613	12,483,647
Pagat dhe Mëditjet	8,423,505	8,423,505	8,150,885	97	8,088,931	7,762,216
Mallrat dhe Shërbimet	1,716,041	1,619,662	1,506,915	93	1,281,894	966,169
Shërbimet komunale	189,113	189,114	187,252	99	150,368	205,586
Subvencionet dhe Transferet	231,347	255,202	245,479	96	232,616	171,737
Investimet Kapitale	4,611,596	5,652,635	4,543,963	80	4,147,803	3,377,939

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore:

- Te mallrat dhe shërbimet, buxheti ishte zvogëluar për 96,379€. Zvogëlimi kishte ndodhur nga huamarrja për 121,937€, ridestinimit nga mallrat për investimet kapitale për 7,400€, rritjes nga të hyrat e bartura për 32,459€ si dhe rritjes nga donacionet për 500€;
- Buxheti për subvencione ishte rritur për 23,855€, rritja kishte ndodhur nga të hyrat e bartura; dhe
- Buxheti për investimet kapitale ishte rritur për 1,041,039€, si rezultat i të hyrave të bartura 755,323€, ridestinimit nga mallrat dhe shërbimet për investimet kapitale për 7,400€, rritjes nga grantet e donatorëve për 271,843€ si dhe nga huamarrja 6,472€.

Çështja B1 - Keq klasifikim i shpenzimeve

Gjetja

UA Nr. 19/2009 për planin kontabël, neni 8.1 dhe 8.3 kanë përcaktuar qëllimin dhe strukturën e planit kontabël, si dhe klasifikimin ekonomik të shpenzimeve të cilat duhen të bëhen sipas kodeve dhe kategorive të caktuara ekonomike.

- Siç kemi paraqitur te theksimi i çështjes, komuna ka paguar dhe regjistruar shpenzime për paga në vlerë 551,242€ nga kategoritë ekonomike jo adekuate. Nga mallrat dhe shërbimet ishin paguar 246,119€, nga subvencionet 16,868€ si dhe nga investimet kapitale 288,255€. Këto pagesa janë kryer nga Thesari në bazë të vendimeve gjyqësore/përmbartimore dhe kanë të bëjnë me kompensimin e pagave jubilarë dhe përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve. Poashtu nga investimet kapitale janë paguar 22,190€ për mallra dhe shërbime. Edhe këto pagesa janë ekzekutuar nga Thesari sipas vendimeve gjyqësore dhe kishin të bënin me borxhet ndaj furnitorëve të ndryshëm.

Kjo ka ndodhur për shkak se nuk kishte mjete të aprovuara me ligjin e buxhetit për pagesën e tyre nga kategoria adekuate. Komuna ka dhënë shpjegimet adekuate në pasqyrat financiare lidhur me këto keqklasifikime, si dhe kishte bërë përpjekje për shmangien e vendimeve gjyqësore pasi që një pjesë e pagave jubilarë/përcjellëse të vitit 2019 ishin paguar nga kategoria e pagave dhe mëditjeve.

Komuna kishte kryer pagesa nga kategoritë ekonomike jo adekuate përmes planifikimit të gabuar, si:

- Nga mallrat dhe shërbimet janë paguar 51,340€ për subvencione dhe transfere. Pagesat kishin të bënin me mbulimin e shpenzimeve të varrimit;
- Nga mallrat e shërbimet janë paguar 13,444€ për shpenzime kapitale. Shpenzimet kanë të bëjnë me kontratën "Rregullimi i sallës së bibliotekës dhe furnizimi me inventar për bibliotekën – Fehmi Lladrovci"
- Nga investimet kapitale janë paguar 36,406€ për mallra dhe shërbime. Shpenzimet ishin sipas kontratave "Inventarizimi në shkollë" pagesa prej 34,956€ si dhe "Blerja e mjeteve të teknologjisë" pagesa prej 1,450€. Po ashtu nga investimet kapitale ishin paguar 6,811€ për subvencione në bujqësi.

Këto kanë ndodhur për shkak të planifikimit të dobët të buxhetit nga ana e komunës dhe aprovimit nga MF dhe Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ndikimi

Keq klasifikimi i shpenzimeve rezulton me pasqyrimin jo të drejtë të shpenzimeve në PFV, dhe rrjedhimisht shpie në keqkuptim të aktiviteteve financiare të komunës.

Rekomandimi B1 Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinoen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.

2.1.1 Të hyrat

Të hyrat e përgjithshme të realizuara nga komuna në vitin 2019 ishin 1,108,521€ apo rreth 15% më pak se vitin paraprak. Të hyrat kanë të bëjnë me të hyrat nga tatimi në pronë, të hyrat nga lejet e ndërtimit, të hyrat nga koncesionet, taksat administrative, të hyrat nga veprimtaritë biznesore, të hyrat nga qiraja etj. Komuna kishte edhe të hyra të arkëtuara nga institucionet tjera në emër të komunës si në vijim: gjobat në trafik 480,525€, dhe gjobat nga gjykatat 26,895€. Poashtu komuna kishte pranuar donacione në vlerë 269,564€.

Tabela 3. Të hyrat(në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2019 Pranimet	% e Realizimit 2019	2018 Pranimet	2017 Pranimet
Të hyrat	1,313,535	1,313,535	1,108,521	84	1,305,375	1,073,197
Te hyrat tatimore	333,941	333,941	511,163	153	468,693	390,186
Te hyrat jo tatimore	979,594	979,594	597,358	61	836,682	683,011

Ne kemi testuar 22 mostra për teste substanciale në vlerë 286,374€, dhe 9 mostra për pajtueshmëri.

2.1.2 Pagat dhe mëditjet

Buxheti final për paga dhe mëditje ishte 8,423,505€, prej tyre janë shpenzuar 8,150,885€. Numri i aprovuar i të punësuarve, sipas buxhetit ishte 1,325 ndërsa në fund të vitit numri i tyre ishte 1,308. Gjatë vitit 2019 ishin punësuar 95 punëtor të rinj. Kemi testuar 54 mostra për teste substanciale në vlerë 23,119€, si dhe 10 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B2 – Mangësi në procedurat e rekrutimit

Gjetja Neni 8 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, ndër të tjera thotë se: Punëdhënësi në sektorin publik, është i obliguar që të shpall konkurs publik sa herë që pranon një punëmarrës dhe themelon marrëdhënie të punës, po ashtu konkursi duhet të jetë i barabartë për të gjithë kandidatët e synuar pa asnjë lloj diskriminimi.

Në konkursin publik të dt. 07.11.2019 për rekrutimin e një “Mësimdhënësi për arsimin fillor” në shkollën Bajram Curri në Nekoc, kemi identifikuar disa mangësi:

- Kandidati i cili është shpërblyer me kontratë, ka arritur të marr pikët e mjaftueshme për të kaluar pragun e nevojshëm prej 50% vetëm pasi ishte mbivlerësuar nga komisioni në testin me shkrim, derisa kundër kandidatët ishin nënvlerësuar nga komisioni në disa pyetje. Po ashtu i njëjti nuk e kishte përvojën e punës të kërkuar me konkursin publik; dhe disa prej dokumenteve të komisionit vlerësues nuk ishin të nënshkruar nga kryetari i komisionit vlerësues.

Kjo gjendje ishte për shkak se komisioni nuk kishte respektuar kërkesat ligjore dhe kriteret e konkursit publik si dhe nuk kishte vlerësuar drejtë të gjithë kandidatet pjesëmarrës në këtë konkurs. Ndërlidhur me çështjen e vlerësimit të testit me shkrim, komisioni vlerësues është arsyetuar se në disa raste ka kandidatë të cilët janë stimuluar me qëllim të motivimit dhe dhënies së mundësisë së intervistimit.

Ndikimi Angazhimi i stafit pa plotësuar kriteret e konkursit publik dhe vlerësimi jo i drejtë i kandidatëve paraqet mos respektim të parimit të konkurrencës, dhe trajtimit të barabartë, si dhe mund të ndikojë në pranimin në punë të personave jo meritator.

Rekomandimi B2 Kryetari duhet të sigurojë se janë zbatuar më përpikëri kërkesat ligjore në proceset e rekrutimit të stafit, në mënyrë që të ketë trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të pranohen kandidatë meritator në bazë të kualifikimeve, përvojës dhe arritjeve në test dhe në intervistë.

2.1.3 Mallrat dhe shërbimet

Buxheti final për mallra dhe shërbime (përfshirë shërbimet komunale) në vitin 2019 ishte 1,808,777€, prej tyre ishin shpenzuar 1,694,167€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me shërbime kontraktuese, shërbime komunale, furnizime të ndryshme për zyre, mirëmbajtjen e objekteve dhe pajisjeve etj. Kemi testuar 36 mostra për teste substanciale në vlerë 224,136€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja A1 - Dobësi në procesin e planifikimit të prokurimit

Gjetja Sipas nenit 5.3 të RRUOPP, planifikimi i prokurimit është një proces i ndërmarrë nga AK për të planifikuar aktivitetet për një periudhë kohore prej 12 muaj. Një planifikim i mirëfilltë eliminon prokurimet emergjente, mbledhë kërkesat e njësisve duke reduktuar edhe kostot e prokurimit si dhe evidenton ndarjen e kërkesave të njëjta të prokurimit.

Komuna gjatë vitit 2019, ka zhvilluar tri procedura të prokurimit për natyrën e njëjtë të furnizimit "Furnizim ushqim dhe pije për nevojat e QEAB Ardhmëria". Si rezultat janë lidhur tri kontrata⁵ me vlerë totale prej 26,060€. Ndërsa, për këtë aktivitet të prokurimit komuna ka paraparë në planifikimin e prokurimit një aktivitet për vitin 2019 në vlerë prej 10,000€.

Kjo gjendje ishte për shkak të planifikimeve jo të sakta të njësisë kërkuese në kontratën e parë e cila ishte lidhur për një periudhë tre mujore. Si rezultat, komuna ishte detyruar të nënshkruante aneks kontratë sipas procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë, tutje kontrata e tretë ishte lidhur për të mbuluar nevojat e qerdhes për furnizimet me ushqim dhe pije për një periudhë një vjeçare.

Ndikimi Mos planifikimi i duhur i prokurimit mund të rezultojë në prokurime emergjente ose përjashtime, si dhe në ndarjen e kërkesave për prokurime të njëjta dhe rrjedhimisht ndikon në mos arritjen e vlerës për para.

Rekomandimi A1 Kryetari duhet të sigurojë që njësitë kërkuese parashikojnë në mënyrë më të saktë nevojat për furnizime vjetore dhe në bashkëpunim me departamentin e prokurimit të bëjnë një planifikim të prokurimit duke zbatuar kërkesat ligjore.

2.1.4 Subvencionet dhe transferet

Buxheti final për subvencione dhe transfere ishte 255,202€, prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 245,479€. Ato janë dhënë për entitete publike dhe jopublike dhe kanë të bëjnë kryesisht me përkrahjen e sektorit të bujqësisë, kulturës, sportit dhe aktiviteteve tjera në kuadër të komunës.

⁵ Kontrata e parë është me dt. 25.03.2019 prej 7,452€ (me afat deri me 30.06.2019), Aneks kontrata e dt. 20.06.2019 prej 700€, dhe kontrata e fundit e dt. 22.07.2019 në vlerë prej 17,907€ për një periudhë një vjeçare.

Kemi testuar 6 mostra për teste substanciale në vlerë 41,177€ si dhe 6 mostra për teste të pajtueshmërisë.

2.1.5 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 5,652,635€ prej tyre në 2019 ishin shpenzuar 4,543,963€. Ato kanë të bëjnë kryesisht me ndërtimin dhe rregullim të infrastrukturës rrugore, ujësjellësit dhe kanalizimeve, ndërtim të shkollave dhe parqeve, shpronësime, blerje të pajisjeve dhe përmirësime të ndryshme të kapitalit. Kemi testuar 90 mostra për teste substanciale në vlerë 2,244,285€ si dhe 5 mostra për teste të pajtueshmërisë.

Çështja B3 - Mungesa e projektit ekzekutues

Gjetja Neni 20 pika 10 i Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik (RRUOPP) kërkon që specifikat teknike për kontratën e punës, duhet të përfshijnë një projekt ekzekutues si pjesë substanciale të veten.

Kemi identifikuar se në 23 kontrata pune komuna nuk kishte hartuar projektin ekzekutues, por i kishte zhvilluar procedurat e prokurimit duke përgatitur vetëm paramasën dhe parallogarinë. Mungesa e projekteve ekzekutuese kryesisht ishte tek ndërtimi i kanalizimeve, rrugëve, dhe infrastrukturës tjetër. Komuna kishte kontratë me një operator për hartimin e projekteve, mirëpo nuk ishte e kënaqur me cilësinë e projekteve të marra nga operatori, prandaj procedurat e prokurimit janë zhvilluar vetëm me paramasë dhe parallogari.

Ndikimi Mungesa e projekteve ekzekutuese dhe inicimi i procedurave për projekte kapitale vetëm me paramasë dhe parallogari, rritë rrezikun që gjatë procesit të ekzekutimit të projekteve të paraqiten pengesa të ndryshme si në aspektin e profesional ashtu edhe në vonesat e punimeve apo edhe në rritjen e kostove të projekteve.

Rekomandimi B3 Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit hartohen specifika dhe kushte të qarta për të siguruar ekonomikitetin/efikasitetin dhe efektivitetin e blerjeve të realizuara. Po ashtu, të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues.

Çështja A2 - Mangësi në procedurat e prokurimit

Gjetja Paragrafi 3 i nenit 56 i LPP-ës përcakton se: “Tenderuesi, gjatë procedurave të hapura, ose kandidati, gjatë procedurave të kufizuara dhe procedurave konkurruese me negociata, nuk do të diskualifikohet ose përjashtohet nga procedurat e tilla në baza të ndonjë kërkesë ose kriteri që nuk është i cekur në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit”. Sipas nenit 39 të RrUOPP “Për të lehtësuar ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga secili tenderues individualisht për sqarim të tenderit të tij/saj për të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender”.

Te aktiviteti i prokurimit “Ndërtimi i Rrugës Vuqak -Tërdec (projekt tre vjeçar)” i cili ka rezultuar me kontratë prej 328,641€, bazuar në procesverbalin e hapjes kemi evidentuar se çmimi i ofertës më të lirë ishte 310,110€. Megjithatë, kjo ofertë ishte eliminuar për shkaqet e paraqitura në “Letrën standarde për tenderuesin e eliminuar”, e që kishin të bënin me mungesën e dokumentacionit⁶ në tenderin në fjalë, mirëpo sipas kërkesave ligjore të gjitha këto dokumente mund të kërkoreshin gjatë procesit të vlerësimit përmes sqarimit të tenderëve ose nuk ishin kërkuar fare në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit.

Kjo gjendje ishte për shkak të mungesës së njohurive lidhur me kërkesat ligjore për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve.

Ndikimi Mos zbatimi i kërkesave ligjore për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ka ndikuar në eliminimin e tenderit me çmimin më të ulët pa shterur të gjitha mundësitë për t’u siguruar se ka pasur bazë të mjaftueshme për eliminimin e tij.

Rekomandimi A2 Kryetari duhet të sigurojë se stafi i caktuar në menaxhimin e procedurave të prokurimit janë në njohuri me kërkesat rregullative ligjore për prokurimin publik dhe se aplikojnë kontrollet në të gjitha fazat e tij.

⁶ Dokumentet të cilat i kanë mungu dosjes dhe të cilat janë cekur në letrën standarde të njoftimit për tenderuesin e eliminuar janë: plani dinamik, certifikata e TVSH-së dhe ë numrit fiskal, Marrëveshjes për asfalt i mungon certifikata e biznesit dhe numrit fiskal, lista e stafit e pa vulosur dhe e pa nënshkruar. Mirëpo plani dinamik nuk ishte i kërkuar në dosje të tenderit/njoftimit për kontratë, ndërsa të tjerat ka mundur të kërkohej përmes sqarimit të tenderit, për pikën e fundit OE ka dorëzuar listën e pa nënshkruar dhe të pa vulosur për stafin por ka dorëzuar edhe listën e stafit të nxjerrë nga ATK dhe e cila nuk ka nevojë të jetë e nënshkruar.

Çështja A3 – Pagesë për punë të pakryera

Gjetja Rregulla financiare Nr. 01/2013 për shpenzimin e parasë publike, nenet 22 deri 26, ndër të tjera përcaktojnë se paraprakisht duhet të bëhet pranimi i mallrave/furnizimeve pastaj duhet të bëhet pagesa.

Te kontrata e dt. 27.12.2019 për "Ndërtimin e kolektorëve për grumbullimin e ujërave të zeza në Komunën e Drenasit" LOT 1 në vlerë 229,120€, kemi vërejtur se vetëm 3 ditë pas nënshkrimit të kontratës (30.12.2019) ishte realizuar pagesa prej 132,090€ (57% e vlerës së kontratës) për furnizimin e gypave sipas pozicioneve 6.1: 6.1.1; 6.1.2 dhe 6.1.3. Sipas raportit të menaxherit të kontratës dhe organit mbikëqyrës kishte ndodhur vetëm furnizimi i gypave por jo edhe montimi ashtu siç parashihet në pozicionin 6.1 të paramasës. Mirëpo, bazuar në dëshmitë e siguruara (foto të gypave dhe deklaratën e OE) kemi vërtetuar se nuk kishte ndodhur as furnizimi.

Sipas zyrtarëve të komunës, pagesa ishte realizuar për të mos lejuar që mjetet të shkonin në suficit. Duhet theksuar se gjatë kohës sa ishim në auditim (fillimi i korrikut 2020) ky projekt ishte në proces të pranimi teknik.

Ndikimi Dobësitë në pranimin e furnizimeve/punëve nga menaxheri i kontratës dhe organit mbikëqyrës ndikon në ekzekutimin e pagesave për punë të pa kryera dhe mund të rezultojë me dëmtim të buxhetit dhe keqpërdorim të parasë publike.

Rekomandimi A3 Kryetari duhet të siguroj se menaxherët e kontratave dhe organi mbikëqyrës aplikojnë kontrolle efektive në menaxhimin e kontratave dhe pranimin e furnizimeve/punëve si dhe pagesat bëhen vetëm për furnizimet/punët e realizuara.

Çështja A4 - Tejkalim i pozicioneve të kontratës publike kornizë

Gjetja Neni 56.10 i RrUOPP ndër të tjera thotë se: "Mospërputhja e lejuar +/- 30% vlen edhe për Lote dhe për pozicion/artikull dhe në rast të arritjes së pragut të lejuar AK nuk mund të bëj porosi tjera për atë Lot apo pozicion/artikull.

Te kontrata publike kornize për "Mirëmbajtjen e ndriçimit publik" prej 43,333€, kemi verifikuar se në 4 pozicione⁷ kishte tejkalim mbi 30% e lejuar të sasive të kontraktuara, kjo nuk ka ndikuar në tejkalimin e vlerës totale indikative të kontratës. Poashtu, te kjo kontratë nuk është përdorur shablloni i kontratës kornize sipas dosjes se tenderit për kontratat kornize dhe nuk e ka specifikuar se lejohet devijimi +/- 30%.

Kjo gjendje ishte për shkak të neglizhencës së zyrës së prokurimit gjatë menaxhimit me procedurat e prokurimit dhe hartimit të kontratave.

Ndikimi Dobësitë në furnizime duke tejkaluar sasinë e kontraktuara përtej sasive të lejuara për disa produkte do të ndikojë negativisht dhe do të pamundësojë furnizimin e produkteve tjera të nevojshme.

Rekomandimi A4 Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e nënshkruara të përmbajnë çmimet e sakta dhe devijimet e lejuara, si dhe të kërkojë nga zyrtarët përgjegjës që mos te tejkalohe devijimet përtej limiteve të devijimit të përcaktuara me kontratën publike kornizë.

⁷ Pozicioni 9=sasia e kontraktuar ishte 150, ndërsa ishte realizuar 279 apo 84 mbi sasinë e lejuar; pozicioni 10=sasia e kontraktuar ishte 70, ndërsa ishte relizuar 93 apo 2 mbi sasinë e lejuar; pozicioni 13=sasia e kontraktuar ishte 2,450 ndërsa ishte realizuar 3,385 apo 200 mbi sasinë e lejuar si dhe pozicioni 33=sasia e kontraktuar ishte 25 ndërsa ishte realizuar sasia 121 apo 88.5 mbi sasinë e lejuar.

2.1.6 Çështjet e përbashkëta për mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale

Në vijim janë çështjet e përbashkëta që kanë të bëjnë me mallrat dhe shërbimet, si dhe investimet kapitale:

Çështja B4 Vonesa në realizimin e furnizimeve/punëve

Gjetja Sipas nenit 2.1 të kontratave dhe neni 22.6 të kushteve të veçanta, kërkohet që furnizimi të kryhet jo më vonë se 3 ditë pas pranimit të kërkesës nga njësia kërkuese, apo nga koha e lëshimit të urdhërbljes.

Në tri pagesa kemi hasur në vonesa në liferimin e furnizimeve si dhe nuk janë aplikuar ndëshkime/penale të përcaktuara në kontratë, si:

- Te pagesa në vlerë 10,800€ për kontratën "Furnizim me dru zjarri (bungu & qarri) për nevojat e institucioneve arsimore dhe shëndetësore Drenas", vonesat në dorëzimin e furnizimeve të druve ishin nga 46 deri në 62 ditë, vonesat ishin për shkak të pa përgjegjshmërisë së OE;
- Te pagesa në vlerë 7,561€ për kontratën "Furnizim me material shpenzues mjekësor dhe ampula", vonesat ishin 10 ditë, vonesat ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të kërkesave për furnizime, dhe
- Te pagesa në vlerë 2,712€ për kontratën "Furnizim me artikuj - material elektrik, veglari dhe llaqe, artikujt e sanitarisë dhe artikujt bujqësorë", vonesat ishin 16 ditë mbi afatin e përcaktuar 3 ditë të kontratës, vonesat ishin për shkak të menaxhimit jo adekuat të kërkesave për furnizime.

Vonesa në realizim kemi identifikuar edhe në dy kontrata të punës. Vonesat ishin raportuar nga menaxherët e kontratave dhe nuk ishin të arsyetuar mirëpo nuk ishin aplikuar penale/ndëshkime për këto vonesa, si:

- Te kontrata "Ndërtimi i depove për lëndë djegëse në shkollë" prej 44,918€, vonesat ishin 40 ditë; dhe
- Te kontrata "Rrethojat e fushave sportive për shkollë" prej 57,351€ vonesat ishin 44 ditë.

Ndikimi Vonesat në liferimin e mallit dhe realizimin e punëve mund të paraqesin pengesë për zhvillimin e aktiviteteve operacionale të komunës ndërsa mos aplikimi i penaleve përveç ndikimit financiar, ndikon edhe në uljen e përgjegjësisë së OE në përmbushjen e afateve të kontraktuara.

Rekomandimi B4 Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha furnizimet dhe punët të pranohen sipas kushteve të kontraktuara, dhe në rastet e pajustificuara të vonesave në liferim të mallit/kryerje të punëve, të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.

Çështja B5 - Shpenzime të larta procedurale të pagesave të ekzekutuara sipas vendimeve gjyqësore

Gjetja Sipas Nenit 39 i LMFPP, çdo faturë e vlefshme dhe kërkesë për pagim të mallrave dhe shërbimeve të furnizuara ose punëve të realizuara duhet të paguhet brenda 30 ditëve kalendrike pas pranimit të faturës ose kërkesës së vlefshme për pagesë. Po ashtu Ligji Nr. 06/L-133 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2019 dhe plani kontabël definojnë qartë se shpenzimet duhet të ndodhin nga kategoritë adekuate ekonomike.

Ne kemi identifikuar se Thesari kishte ekzekutuar në bazë të vendimeve gjyqësore pagesa në vlerë prej 600,322€. Kjo formë e pagesave, përveç ndikimit në keqklasifikimin e shpenzimeve (që është trajtuar tek opinioni i auditimit), ka ndikuar edhe në rritjen e shpenzimeve, ngase borxhi kryesor ndaj pretenduesve ishte 416,618€ ndërsa shpenzimet procedurale të përmbarrimit ishin 183,704€.

Pagesat kishin të bëjnë kryesisht me detyrimet e dala nga marrëveshja kolektive për kompensimin e tri pagave jubilarë dhe tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit të punonjësve, borxhe të pa paguara ndaj furnitorëve si dhe për çështje të problemeve pronësore.

Arsyet e ekzekutimit të pagesave të tilla vijnë si rezultat i planifikimit të dobët dhe mungesës së buxhetit nga programet përkatëse për këto raste.

Ndikimi Situata e krijuar që pagesat të ekzekutohen direkt nga ana e Thesarit përmes procedurave të përmbarrimit ka ndikuar në rritjen e kostos për Komunën dhe në keqklasifikimin e shpenzimeve.

Rekomandimi B5 Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPP.

Çështja A5 - Ndryshime në pozicionet e kontratave pa aprovimin paraprak të ZKA-së

Gjetja

Neni 61.21 RrUOPP specifikon se “Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer”, dhe neni 61.22 thotë se “ndryshimi i kontratës do të përgatitet nga departamenti i prokurimit”, ndërsa neni 61.23 thotë se kjo mund të bëhet “vetëm pas marrjes së aprovimit nga Zyrtarit Kryesor Administrativ”.

Gjatë testimit të pagesave ne kemi identifikuar 14 kontrata⁸ në të cilat kishte pasur devijime apo ndryshime të sasive të realizuara nëpër disa pozicione, duke rritur/zvogëluar sasinë e kontraktuar apo në disa raste duke mos realizuar fare pozicionet e kontraktuara, por pa rritur çmimin total të kontratës. Për këto ndryshime nuk ishin marrë aprovimet e nevojshme nga zyra e prokurimit dhe nga ZKA ashtu siç kërkohet me nenet 61.22 dhe 61.23 të RrUOPP.

Prej tyre, duhet theksuar ndryshimet realizimin e pozicioneve në tre kontrata:

- Te kontrata "Infrastruktura në fshatin Abri e Epërme dhe Tërdec" me vlerë 48,498€, ndryshimet ishin të shprehura në pozicionet e punimit të tubave atmosferik të cilët nuk ishin punuar sipas kontratës, përkatësisht te segmenti i parë nuk janë vendosur gypat Ø600 dhe Ø400 të cilit ishin të kontraktuar, por janë vendosur gypa Ø315 që nuk ishin fare të kontraktuar (ky pozicion i shtuar nuk ka kaluar nëpër procedura të prokurimit), po ashtu edhe në dy segmentet tjera në vend të gypave Ø800, Ø600 janë vendosur gypa Ø400. Këto ndryshime nuk janë pranuar nga menaxheri i kontratës dhe organi mbikëqyrës dhe nuk janë paguar si pozicione, ndonëse pranimi teknik është bërë me këto ndryshime. Poashtu duhet theksuar se çmimet e kontraktuara për gypat dhe disa pozicione tjera ishin jo normalisht të ulëta (gypi Ø800 ishte kontraktuar 10 cent, gypat Ø600 dhe Ø400 ishin kontraktuar vetëm 1 cent);

⁸ Kontratat: "Ndërtimi i kapacitetit të ujësjellësit në Kamenice" prej 134,282.55€; "Kanalizimi i ujerave të zeza në fshatrat Baicë, Krajkove, Shtuticë dhe Verbovc" 74,601.5€; "Ndërtimin e infrastrukturës (Asfaltimi dhe kubëzimi) në Drenas" prej 132,312.1€; "Ndërtimin e stadionit të qytetit - Faza e dyte" prej 1,750,491.64€; "Asfaltimin e rrugëve në fshatrat Llapushnik, Poterq dhe Vukoc" prej 128,056.9€; "Asfaltimin e rrugëve në fshatrat Shtuticë, Verbovc, Polluzhë, Tërstenik I dhe Tërstenik II" prej 107,359.2€; "Kanalizimi i ujerave të zeza në Arllat, Negroc, Gjergjice, Llapushnik, Poterq dhe Vukoc" prej 53,074.5€; "Termiizolimi i objektit shkollor në SHFMU Mehdi Sylejmani - Bytyq" prej 12,305€; "Kanalizimi i ujerave të zeza në Gllanasellë, Godanc, Dobroshevc, Qikatovë e vjetër, Gradicë dhe Likoshan" prej 95,585.3€; "Kanalizimi I ujerave të zeza në komunën e Drenasit - faza e dytë" prej 42,387.55€; "Intervenime Emergjente" me vlerë 29,096€; si dhe kontrata "Pastrimi i deponive të egra" me vlerë 12,975€; "Infrastruktura në fshatin Abri e Epërme dhe Tërdec" prej 48,498€ dhe "Asfaltimin e rrugëve në fshatrat në Poglek i ri, i Vjetër, Vasilev, Korretice e poshtme dhe e Epërme, Zabel i Poshtëm dhe i Epërm" prej 81,300.2€

- Te kontrata "Kanalizimi i ujerave të zeza në fshatrat Baicë, Krajkovë, Shtuticë dhe Verbovc" në vlerë 74,601€, përveç rritjes dhe zvogëlimit të sasive në disa pozicione, ishte shtuar një pozicion prej 760€ (pa procedurë të veçantë të prokurimit) i cili nuk ishte fare në paramasën e kontraktuar;
- Ndryshim të sasive në disa pozicione kemi identifikuar edhe te kontrata për "Asfaltimin e rrugëve në fshatrat Poklek i ri, Poklek i Vjetër, Vasilevë, Korreticë e Poshtme dhe e Epërme, Zabel i Poshtëm dhe i Epërm" në vlerë 81,300€. Duhet theksuar se në të gjithë segmentet e rrugëve që janë paraparë të asfaltohen me këtë kontratë, pozicionet që kanë të bëjnë me punët e dheut janë kontraktuar çmime jo normalisht të ulëta dhe zyra e prokurimit nuk e kishte trajtuar sipas "Rregullave për tenderët jo-normalisht të ulët" gjatë procedurave të vlerësimit të tenderëve.

Nevoja për ndryshime kishte ardhur për shkak të disa arsyeve si: mungesës së projekteve ekzekutive, problemeve pronësore, specifikave të punëve, konfiguracionit të terrenit ku realizohen punimet si dhe për t'i bërë projektet më funksionale. Ndërsa mos aprovimi i këtyre ndryshimeve ka ndodhur për shkak se menaxherët e projekteve nuk ishin në njohuri për kërkesat ligjore të prokurimit publik lidhur me ndryshimin e kontratave.

Ndikimi

Ndryshimi i paramasës dhe parallogarisë së kontraktuar pa aprovimin e zyrës së prokurimit dhe ZKA-së shpërfaq dobësitë në kontrollet e ushtruara nga menaxhmenti i lartë dhe mund të rezultojë që për shkak të realizimit të kontratës me kushte të ndryshuara nuk është përzgjedhur operatori më i lirë. Po ashtu mos ndjekja e procedurave të prokurimit për realizimin e pozicioneve të cilat nuk kanë qenë të kontraktuara mund të ndikojë në çmime dhe cilësi jo adekuate.

Rekomandimi A5 Kryetari duhet të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA konform procedurave të parapara me ligjin dhe rregullat e prokurimit.

2.2 Pasuritë kapitale dhe jokapitale

Vlera e pasurive kapitale, e paraqitur në PFV ishte 508,301,479€, pasurive jo kapitale ishte 280,805€, dhe e stoqeve 3,446€. Kemi testuar 87 mostra në vlerë 2,238,147€ për teste substanciale, si dhe kemi kryer teste të pajtueshmërisë lidhur me procedurat e brendshme të menaxhimit të pasurive, inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive, funksionimin e sistemit e-pasuria etj.

Çështja B6 - Mangësi në regjistrin kontabël të pasurive

Gjetja Testimet për këtë fushë kanë rezultuar me disa mangësi dhe të cilat janë trajtuar si në vijim:

- Neni 6.3 i Rregullores për 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare kërkon që pasuria kapitale duhet të regjistrohet në SIMFK ndërsa pasuria jo kapitale dhe stoqet duhet të regjistrohet në sistemin e-pasuria. Në tri raste, pagesat për blerjen e pasurive kapitale dhe jo kapitale në vlerë 48,197€ nuk ishin regjistruar në regjistrin e pasurive brenda vitit 2019 (prej tyre një pagesë⁹ me vlerë 11,791€ e cila është regjistruar në SIMFK, në vitin 2020, dhe 2 pagesa¹⁰ prej 36,406€ nuk ishin regjistruar në e-pasuria);
- Sipas nenit 10 të Rregullores Nr. 02/2013 të gjitha pasuritë jo financiare pavarësisht a janë të paguara apo pjesërisht të paguara, duhet të regjistrohen në regjistrat kontabël. Te projekti për "Rregullimin e garazheve për mjetet e shërbimit të zjarrfikësve" kemi evidentuar se regjistrimi i pasurisë ishte bërë gabim, ngase regjistrimi ishte bërë sipas pagesave totale që ishin bërë prej 45,991€, ndërsa është dashur të regjistrohej sipas vlerës së punëve të kryera prej 47,316€; dhe
- Komuna ka kryer procesin e inventarizimit të pasurive jo financiare, mirëpo nuk është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare ashtu siç kërkohet me nenin 19.4.3 të Rregullores 02/2013.

Regjistrimet e gabuara kryesisht ishin për shkak të volumit të madh të punëve në fund vit dhe mos funksionimit efikas të kontrollit.

Ndikimi Mungesa e regjistrave të plotë shkakton mbi apo nënvlerësim të pasurive si dhe mund të rezultojë në prezantimin jo të drejtë të informatave në pasqyra financiare. Mos krahasimi i inventarizimit me gjendjen e regjistrave të pasurive nuk jep siguri lidhur me saktësinë dhe plotësinë e regjistrave të pasurisë.

⁹ Asfaltimin e rrugëve ne qytezën e Komoranit dhe në Korretice të ulët sipas kontratës dhe aneks kontratës 11,791€.

¹⁰ Furnizim me inventar shkollor 34,956€ dhe Pajisje të teknologjisë informative 1,450€.

Rekomandimi B6 Kryetari, duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe në PFV të shpalosen informatat e sakta rreth pasurive.

2.3 Të arkëtueshmet

Në PFV-të e vitit 2019, komuna ka shpalosur llogari të arkëtueshme në vlerë prej 3,149,466€. Kjo vlerë përbëhet nga të arkëtueshmet e tatimit në pronë, taksa në biznes, qiraja, lejet e ndërtimit dhe terasat.

Çështja C1 - Inkasim i ulët i llogarive të arkëtueshme

Gjetja Neni 29 i Ligjit Nr.06/L-005 për tatimin në pronën e paluajtshme, parasheh që nëse edhe pas 180 ditëve kalendrike nga dita e fundit e pagesës dhe pas njoftimit përfundimtar ndaj tatimpaguesit, nëse pagesa ende nuk është paguar, komuna merr vendim mbi ekzekutimin e detyrimeve tatimore të papaguara që kanë kaluar shumën e 300€. Autoriteti që ka marrë këtë vendim, sipas paragrafit 7 të nenit 29 i kërkon autoritetit kompetent përmbarues përmbarimin e vendimit dhe mbledhjen e detyrimeve tatimore të papaguara në përputhje me legjislacionin në fuqi për procedurën përmbarimore. Ndërsa, Rrgullorja komunale nr. 030-19516 për taksa, tarifa, ngarkesa dhe gjoba, neni 6 thote se: “Në rast të mos pagesës se taksës, komuna do të veprojë sipas dispozitave ligjore duke shfrytëzuar të drejtën e mbylljes së subjekteve afariste dhe paraqitjen në gjykatën kompetente. Përkundër trendit të zvogëlimit të llogarive të arkëtueshme në krahasim me vitin e kaluar, edhe gjatë vitit 2019 nuk kishte menaxhim efektiv në mbledhjen e tyre.

Nga 28 mostra e testuara në vlerë 165,489€ të tatimit në pronë, kemi evidentuar vonesa të konsiderueshme në inkasimin e tyre, të cilat janë borxhe të vjetra nga viti 2003 e tutje. Përkundër vërejtjeve ndaj tatimpaguesve mbi 1,000€, pezullimin në disa shërbime komunale si dhe marrëveshjeve të nënshkruara mes tatim paguesve dhe komunës për shlyerjen e borxheve me këste, prapë ka një numër të konsiderueshëm të borxheve, për arkëtimin e të cilave nevojiten veprime shtesë.

- Nga 27 mostra të testuara në vlerë 403,132€ tek taksat në biznes, kemi konsideruar që shumica janë borxhe të vjetra, disa për biznese jo aktive, dhe kishte menaxhim të dobët të programit të taksave ndër vite. Komuna ende nuk ka aktivizuar softuerin e ri për menaxhimin e të hyrave/llogarive të arkëtueshme të taksave në biznes.
- Përderisa disa llogari menaxhohen nga sisteme të integruara (tatimi në pronë, taksa në biznes), llogaritë tjera menaxhohen në Excel dhe të dhënat e prezantuara nuk japin siguri për saktësinë dhe plotësinë e tyre.

Të gjeturat e mësipërme janë shfaqur për shkak se komuna nuk kishte ndërmarrë të gjitha veprimet e mundshme dhe të mjaftueshme për inkasimin e të hyrave nga borxhet e paraqitura në llogaritë e arkëtueshme.

Ndikimi Mungesa e veprimeve konkrete për arkëtimin e llogarive të arkëtueshme mund të rezultojë me rritje të këtyre llogarive, rrezikon që komuna të ketë humbje financiare si dhe rrezikon mos realizimin e projekteve të komunës të financuara nga të hyrat vetjake. Mungesa e softuerëve/data bazës funksionale rrezikon saktësinë dhe plotësinë e informatave për të arkëtueshmet dhe shpalosjen e tyre në PFV.

Rekomandimi C1 Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim.

2.4 Detyrimet

2.4.1 Detyrimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2019, ishte 70,213€. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2020. Kemi testuar 5 mostra substanciale në vlerë 14,545€ si dhe 12 mostra të pajtueshmërisë.

2.4.2 Detyrimet kontigjente

Pasqyra e detyrimeve kontigjente në fund të vitit 2019 ishte 225,949€. Kemi testuar 5 mostra nga kjo kategori në vlerë 152,472€.

Çështja A6 - Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente

Gjetja Sipas Rregullores së MF-Nr.01/2017 Për Pasqyrat Financiare të Organizatave Buxhetore, neni 18 përcakton se: Organizatat Buxhetore në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) raportojnë të gjitha detyrimet kontigjente.

Gjatë testimit të detyrimeve kontigjente, ne kemi vërejtur që vlera 34,167€ ishte përfshirë dy herë në listën e detyrimeve kontigjente duke i mbivlerësuar ato.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i komunikimit jo të mirë ndërmjet zyrës së financave dhe zyrës ligjore.

Ndikimi Mbivlerësimi i detyrimeve kontigjente ka ndikuar në saktësinë e vlerës së detyrimeve kontigjente të prezantuara në PFV.

Rekomandimi A6 Kryetari duhet të sigurohet se zyra ligjore dhe e financave bashkëveprojnë në mënyrë sistematike për të siguruar shpalosje të plota dhe të sakta të detyrimeve kontigjente.

2.4.3 Detyrimet kontraktuale

Sipas të dhënave që na janë ofruar nga komuna, gjendja e detyrimeve kontraktuale deri me datën 31.12.2019 ishte 2,394,064€.

2.5 Funkzioni i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB) operon me dy anëtarë - drejtori dhe një auditor. Përveç planit strategjik, NjAB kishte hartuar edhe planin vjetor të punës ku ishin përfshirë shtatë (7) auditime. Të gjitha këto auditime ishin përfunduar, si dhe një auditim tjetër sipas kërkesës së Kryetarit. Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit ishte 48, prej të cilave 30 ishin zbatuar, 6 ishin në proces dhe 12 ishin të pazbatuara.

Auditimet ishin fokusuar në fushën e prokurimit, pasurive, proceset e shpenzimeve/pagesave, tatimit në pronë, sistemit të pagave dhe mëditjeve dhe subvencioneve. Përderisa periudha e mbuluar me auditim ishte kryesisht viti 2019.

Komiteti i auditimit ishte plotësisht funksional dhe kishte mbajtur pesë (5) takime ku kryesisht ishte diskutuar për raportet e NjAB-së.

Çështja A7 - Mos kompletimi i NjAB-së

Gjetja Neni 5.1.1 i Rregullores 01/2019 për themelimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm përcakton që çdo subjekti i sektorit publik me buxhet mbi 7 milion€ duhet të ketë së paku tre auditorë. NjAB në Komunën e Glllogocit përbëhet nga drejtori dhe një anëtar.

Ndikimi Mos kompletimi i NjAB me staf të mjaftueshëm, mund të ndikojë që auditimi i brendshëm mos të mbulojë të gjitha fushat me rrezik, dhe t'i pamundësoj menaxhmentit marrjen e veprimeve me kohë për parandalimin e gabimeve të mundshme.

Rekomandimi A7 Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.

3. Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e Komunës së Glllogocit për vitin 2018 ka rezultuar me 15 rekomandime. Komuna kishte përgatitur një Plan Veprimi ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohet rekomandimet e dhëna. Komuna po ashtu ka përgatitur raportin periodik për zbatimin e rekomandimeve (30 shtator) por jo edhe raportin periodik i cili duhej të dorëzohej deri me 30 mars 2020 sipas kërkesave të dalura nga Rregullorja e Punës për zbatimin e auditimit dhe planeve të veprimit.

Megjithatë konstatimet e zyrtarëve komunal lidhur me implementimin e rekomandimeve nuk përputhen plotësisht me gjendjen e konstatuar nga auditimi. Sipas vlerësimeve të komunës në raportin e zbatimit të rekomandimeve, 12 janë zbatuar dhe 3 në proces të zbatimit, derisa ne kemi vlerësuar se deri në fund të auditimit tonë për vitin 2019, 5 rekomandime janë zbatuar, 1 ishte në proces, 6 nuk janë zbatuar si dhe 3 ishin mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni në Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2019

Nr	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2018	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	PFV	Kryetari, duhet të siguroj se janë ndërmarrë veprime për t'i adresuar shkaqet për Theksim të Çështjes në opinionin e auditimit. Veprime konkrete duhet të ndërmerren për të eliminuar gabimet në planifikimin/buxhetimin e shpenzimeve dhe klasifikimin e tyre. Gjithashtu, informatat lidhur me shpalesjen e pasurive duhet të jenë të plota me qëllim të prezantimit të tyre të plotë dhe të saktë në PFV.	Edhe këtë vit ka keq klasifikime të njëjta. Po ashtu kemi identifikuar pasuri të pa regjistruara. Rekomandimet janë dhënë në fushat përkatëse.	Rekomandim i mbyllur
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurohet që planifikimet për shpenzime të bëhen konform ligjit të buxhetit dhe kodeve ekonomike të përcaktuara sipas planit kontabël për kategori.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë.	Rekomandim i pa zbatuar Ref. B1
3	Pagat dhe mëditjet	Kryetari, duhet të sigurojë se në procesin e rekrutimit ka emëruar komisione profesionale me qëllim që gjatë procesit të vlerësimit të respektohen plotësisht kriteret e kërkuara në mënyrë që të sigurohet që vetëm kandidatët meritator kanë fituar pozitat e punës.	Edhe këtë vit gjendja është njëjtë.	Rekomandim i pa zbatuar Ref B2
4	Pagat dhe	Kryetari, duhet të siguroj se angazhimi me	Ka avancim në	Rekomandim

	mëditjet	MShV bëhet vetëm për punë specifike dhe kontratat nuk zgjasin më shumë se afati i paraparë ligjor. Po ashtu, duhet të ndërmerren veprime që nevojat për pozitat të rregullta të adresohen në MF gjatë planifikimit buxhetor dhe të sigurohet se buxhetohen dhe paguhen nga kategoria e pagave e mëditjeve.	këtë çështje. Për shkak të rëndësisë së vogël rekomandimi është dhënë në letërmenaxhment.	i mbyllur
5	Mallrat dhe Shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë kontrolle shtesë me rastin e pranimit të propozimit për përmbarrim, në rastet kur ka mos pajtime lënda të procedohet në gjykatë, njëherit duhet siguruar që për të gjitha rastet e kryerjes së punëve të përdoren procedurat e nevojshme të prokurimit si dhe të gjitha dokumentet duhet protokolluar pa përjashtim.	Nuk kemi hasur në raste të tilla gjatë këtij viti.	Rekomandim i zbatuar
6	Mallrat dhe Shërbimet	Kryetari, duhet të sigurojë kontrolle shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha mallrat dhe shërbimet të pranohen sipas kushteve kontraktuale, dhe në rastet e vonesave në liferimin e mallrave dhe shërbimeve të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë.	Edhe në këtë vit gjendja është e njëjtë, pasi kemi identifikuar tri raste të vonesave të furnizimeve dhe dy raste të kontratave për punë.	Rekomandim i pa zbatuar Ref. B5
7	Mallrat dhe Shërbimet	Kryetari duhet të sigurojë se do të respektohen kërkesat e paraqitura në dosjen e tenderit, në mënyrë që vetëm operatorët që kanë përmbushur të gjitha kushtet, të shpërblehen me kontratë. Gjithashtu, duhet siguruar që ndarja e detyrave dhe përgjegjësi në aktivitetet e prokurimit të parandalojë mundësinë e konfliktit të interesit.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë këtij viti.	Rekomandim i zbatuar
8	Subvencione dhe Transfere	Kryetari duhet të sigurojë që subvencionimi të bëhet në harmoni të plotë me rregulloren për subvencione dhe çdo shmangie nga kjo rregullore të analizohet dhe gabimet të korrigjohen. Marrëveshjet të hartohen para shpërndarjes së mjeteve të përfituesit, dhe të rriten kontrollet monitoruese pas shpërndarjes së subvencioneve.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë këtij viti.	Rekomandim i zbatuar
9	Investimet Kapitale	Kryetari duhet të siguroj se aplikohen kushtet e kontratës, dhe procedimi i urdhër bërjeve bëhet vetëm pas	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë këtij viti.	Rekomandim i zbatuar

		nënshkrimit të kontratës.		
10	Investimet Kapitale	Kryetari, duhet të forcoj kontrollet për të siguruar se janë hartuar projektet ekzekutive sipas UOPP për përgatitjen e specifikimeve teknike për kontratat për punë. Proceset e prokurimit për projekte ekzekutive duhet të kryhen në fillim në mënyrë që t'i paraprijnë inicimit të prokurimit të projekteve tjera për punë.	Edhe këtë vit gjendja është njëjtë.	Rekomandim i pa zbatuar Ref B3
11	Çështjet e përbashkëta	Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu, obligimet të paguhen brenda afateve të parapara ligjore, për të shmangur pagesat me vendime përmbarimore dhe me kosto më të lartë.	Edhe këtë vit gjendja është e njëjtë, kemi identifikuar raste të keqklasfikimeve e nga vendimet gjyqësore.	Rekomandim i pa zbatuar Ref. B4
12	Menaxhimi i Pasurive	Kryetari, duhet të sigurohet që regjistri i pasurive azhurnohet me të gjitha informatat relevante në mënyrë që të gjitha pasuritë e Komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive duke mos e nënvlerësuar pasurinë në PFV, gjithashtu të sigurojë evidentimin e pasurisë jokapitale në sistemin e E-Pasurisë.	Edhe këtë vit gjendja është njëjtë.	Rekomandim i pa zbatuar Ref B6
13	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e të arkëtueshme, duke siguruar procedura të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre. Posedimi i një plani dhe programi operativ dhe veprimet ligjore përmes përmbaruesve do ta rrisin nivelin e mbledhjes së borxheve.	Janë marrë disa veprime në krahasim me vitin e kaluar mbeten të njëjta nën/mbi vlerësime të saldove si dhe inkasimi i ulët.	Rekomandim në proces të zbatimit Ref. C1
14	Obligimet	Kryetari, duhet të sigurojë komunikim efektiv në mes të drejtorive, për të mundësuar një raportim të plotë të obligimeve siç edhe kërkohet me rregullën financiare 02/2013. Po ashtu duhet siguruar kontrole në ekzekutimin e pagesave, për të eliminuar vonesat në pagesën e faturave.	Nuk kemi hasur raste të tilla gjatë këtij viti.	Rekomandim i zbatuar
15	Raportimi Menaxherial	Kryetari, duhet të sigurojë vendosjen e proceseve efektive të menaxhimit të rrezikut nëpër sektorët përkatës të	Gjendja është e njëjtë edhe këtë	Rekomandim i mbyllur i pa

		organizatës, të siguroj se është përcaktuar forma e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë.	vit.	zbatuar.
Nr.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2019		
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Kryetari duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet që shpenzimet të planifikohen në ndarjet adekuate të buxhetit (apo të ridestinohen mjetet kur është e nevojshme dhe e mundshme) dhe që pagesa e regjistrimi i shpenzimeve bëhet në mënyrë strikte sipas kodeve ekonomike adekuate.		
2	Pagat dhe mëditjet	Kryetari duhet të sigurojë se janë zbatuar më përpikëri kërkesat ligjore në proceset e rekrutimit të stafit, në mënyrë që të ketë trajtim të barabartë të kandidatëve dhe të pranohen kandidatë meritore në bazë të kualifikimeve, përvojës dhe arritjeve në test dhe në intervistë.		
3	Mallra dhe shërbime	Kryetari duhet të sigurojë që njësitë kërkuese parashikojnë në mënyrë më të saktë nevojat për furnizime vjetore dhe në bashkëpunim me departamentin e prokurimit të bëjnë një planifikim të prokurimit duke zbatuar kërkesat ligjore.		
4	Investime Kapitale	Kryetari duhet të sigurojë se për të gjitha aktivitetet e prokurimit hartohen specifika dhe kushte të qarta për të siguruar ekonomicitetin/efikasitetin dhe efektivitetin e blerjeve të realizuara. Po ashtu, të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me punë të mos iniciohen pa u siguruar specifika të qarta sipas projektit ekzekutues.		
5		Kryetari duhet të sigurojë se stafi i caktuar në menaxhimin e procedurave të prokurimit janë në njohuri me kërkesat rregullative ligjore për prokurimin publik dhe se aplikojnë kontrollet në të gjitha fazat e tij.		
6		Kryetari duhet të sigurojë se menaxherët e kontratave dhe organi mbikëqyrës aplikojnë kontrole efektive në menaxhimin e kontratave dhe pranimin e furnizimeve/punëve si dhe pagesat bëhen vetëm për furnizimet/punët e realizuara.		
7		Kryetari duhet të sigurojë që kontratat e nënshkruara të përmbajnë çmimet e sakta dhe devijimet e lejuara, si dhe të kërkojë nga zyrtarët përgjegjës që mos te tejkalohen devijimet përtej limiteve të devijimit të përcaktuara me kontratën publike kornizë.		
8	Çështjet e përbashkëta për M&Sh si dhe IK	Kryetari, duhet të sigurojë kontrole shtesë të monitorimit në mënyrë që të gjitha furnizimet dhe punët të pranohen sipas kushteve të kontraktuara, dhe në rastet e pajustificuara të vonesave në liferim të mallit/kryerje të punëve, të aplikohen ndëshkimet e përcaktuara me kontratë		
9		Kryetari duhet të sigurojë bashkëpunim me MF ashtu që obligimet që dalin nga marrëveshja kolektive të planifikohen/buxhetohen dhe paguhen në kohën e duhur nga kategoria e pagave dhe mëditjeve. Gjithashtu obligimet të paguhen brenda afateve kohore të parapara ligjore sipas LMFPF.		
10		Kryetari duhet të sigurojë se çdo ndryshim në kushtet e kontratës para ose		

		gjatë periudhës së zbatimit do të bëhet vetëm pas njoftimit të zyrës së prokurimit dhe marrjes së aprovimit nga zyra e prokurimit dhe ZKA konform procedurave të parapara me ligjin dhe rregullat e prokurimit.
11	Pasuritë kapitale dhe jo kapitale	Kryetari, duhet të sigurohet se të gjitha pasuritë e komunës janë identifikuar dhe regjistruar saktë në regjistrat përkatës të pasurive komunale. Po ashtu duhet siguruar se është bërë krahasimi i gjendjes së inventarizuar me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare dhe në PFV të shpalosen informatat e sakta rreth pasurive.
12	Të arkëtueshmet	Kryetari, duhet të sigurojë efikasitet më të lartë në arkëtimin e llogarive të arkëtueshme. Hartimi dhe aplikimi i programeve dhe procedurave të qarta për mënyrën e menaxhimit dhe arkëtimit të tyre, do të ndihmonte në këtë drejtim
13	Detyrimet kontigjente	Kryetari duhet të sigurohet se zyra ligjore dhe e financave bashkëveprojnë në mënyrë sistematike për të siguruar shpalosje të plota dhe të sakta të detyrimeve kontigjente.
14	Funksionimi i Auditimit të brendshëm	Kryetari, duhet të sigurojë se për pozitat e kërkuara do të bëhen planifikimet buxhetore me kohë dhe se Njësia e Auditimit të Brendshëm do të plotësohet me staf të mjaftueshëm sipas rregullores në fuqi.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA-ja

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pamodifikuar** nëse arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë keqdeklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit arrin në përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se Pasqyrat Financiare si tërësi nuk përmbajnë keqdeklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse Pasqyrat Financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në Pasqyrat Financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale, por nuk janë përhapur në Pasqyrat Financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të

cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë materiale, por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në Pasqyrat Financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi Pasqyrat Financiare kanë mundur të jenë, edhe materiale, edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi Pasqyrat Financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë Pasqyrat Financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhen t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të Pasqyrave Financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në Pasqyrat Financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letër e konfirmimit



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E DRENASIT
Zyra e Kryetarit
Data, 30.07.2020
01 Nr. 252 - 28140



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2019 dhe për implementimin e rekomandimeve

Për: Zyrën e Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Komunës së Glllogocit, për vitin 2019 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Z. Ramiz Lladrovci *pi*
Kryetar i Komunës së Glllogocit

Data: 30.Korrik.2020, Glllogoc,

